



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada-Government

MINISTRIA E ARSIMIT E SHKENCËS DHE E TEKNOLOGJISË
MINISTARSTVO ZA OBRAZOVANJE NAUKU I TEHNOLOGIJU
MINISTRY OF EDUCATION SCIENCE AND TECHNOLOGY

LISTË DISTRIBUIMI/ CIRKULARNO PISMO/ ROUTING SLIP

REFERENCË:					
PËR/ZA/TO:	Shyqeri Bytyqi, Ministër i Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë së Republikës së Kosovës				
CC:					
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Dr.sc. Gjon Berisha - <i>sekretar shkencor</i>				
NGA/OD/FROM:	Prof. assoc. dr. Sabit Syla, <i>drejtor</i>				
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Raport vjetor i punës - 2017				
Nr. i zyrës:		Lokacioni:		Data:	
Br. kancelarije:		Kucni:	Instituti i Historisë	Datum:	28/12/2017
Room No.:		Extension:		Date:	
PËR MIRATIM/ZA USVAJANJE/FOR APPROVAL					X
PËR NËNSHKRIM/ZA POTPIS/FOR SIGNATURE					X
PËR INFORMIMIN TUAJ/ZA VASU INFORMACIJU/FOR YOUR INFORMATION					X
AFATI/KRAJNI ROK/DEADLINE					

I nderuar, ministër i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Republikës së Kosovës.

Në kuadër të veprimtarisë themelore të Institutit për rezultate të punës kërkimore - shkencore, në pajtim me Projektligjin, Ligjin dhe me Statutin, po u dërgojmë Raportin Vjetor të Punës për vitin 2017.

1. VEPRIMTARIA KËRKIMORE-SHKENCORE

1.2. Organizimi i Konferencave dhe Sesioneve shkencore

Bazuar në Planin e punës për vitin 2017, IH ka organizuar disa Konferenca Shkencore, përmes së cilave ka synuar që të arrihen rezultate dhe njohuri të reja në fushën e historiografisë shqiptare dhe më gjerë. Gjithsej në këtë vit janë organizuar dy konferenca shkencore për tematika dhe periudha të ndryshme historike dhe një ekspozitë tematike:

a. Konferenca shkencore: 50 vjet të Institutit të Historisë “Ali Hadri” – Prishtinë

Më 15 maj të vitit 2017, Instituti i Historisë “Ali Hadri” - Prishtinë organizoi Konferencën shkencore: “50 vjet të Institutit të Historisë “Ali Hadri” - Prishtinë”. Fjalën e hapjes e mbajti prof. asoc. dr. Sabit Syla, drejtor i Institutit të Historisë “Ali Hadri”.

Me fjalë rasti punimet e Konferencës i përshëndetën: Hashim Thaçi - president i Republikës së Kosovës, akademik Arsim Bajrami - ministër i MASHT-it, Akademik Marenglen Verli - drejtor i Qendrës së Studimeve Albanologjike të Shqipërisë, Enver Hoxhaj - ministër i Punëve të Jashtme dhe mr. Lumi Hadri-Devine - vajza e Ali Hadrit.

Në këtë Konferencë u lexuan këto kumtesa: Fehmi Rexhepi, Themelimi, veprimtaria dhe funksionimi i Institutit të Historisë 1967-2000, Sabile Basha, Ali Hadri - drejtor i parë i Institutit të Historisë, Beqir Meta, Bashkëpunimi midis Institutit të Historisë-Tiranë dhe Institutit të Historisë-Prishtinë, gjatë viteve 2008-2017 dhe perspektivat; Marenglen Verli, Një ekspozitë e shkurtër rreth kontributit të Institutit të Historisë-Tiranë për historinë e Kosovës në vitet 1981-2007, Jusuf Bajraktari, Puna dhe vështirësitë e Institutit të Historisë 2000-2012, Frashër Demaj, Bashkëpunimi ndërkombëtar i Institutit të Historisë 2000-2016, Izber Hoti, Qasje hulumtuese në Entin-Institutin e Historisë në Prishtinë, Haki Kasumi, Projektet shkencore të Institutit të Historisë, Teuta Shala, Aktivitetet shkencore të Institutit të Historisë gjatë viteve 1967-2016, Gjon Berisha, Veprimtaria botuese e Institutit të Historisë.

b. Konferencë shkencore: “Shotë Galica dhe Lëvizja Çlirimtare”

Më 30 qershor të vitit 2017, Instituti i Historisë në bashkëorganizim me Kuvendin Komunal të Vushtrrisë realizuan në Vushtrri Sesionin shkencor kushtuar jetës dhe veprimtarisë së heroinës Shotë Galica, me rastin e 90-vjetorit të vdekjes.

Në këtë Sesion me kumtesa u paraqitën këta studiues: Sabile Basha, Kontributi i Shotë Galicës në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare (1915-1927); Marenglen Verli, Shotë Galica përtej miteve dhe Tabuve; Ibrahim Gashi, Qëndrimi i shtetit shqiptar ndaj lëvizjes së rezistencës në Kosovë 1918-1928; Fatmira Musaj, Shotë Galica në panteonin e luftëtarëve të shquara të kombit; Liman Rushiti, Veprimtaria e Shotë Galicës në çetat luftarake; Lush Culaj, Shotë Galica dhe Komiteti Mbrojtja Kombëtare e Kosovës; Sabit Syla, Trajtimi i Lëvizjes Çlirimtare (Kaçake) në historiografinë shqiptare; Izet Miftari, Zona neutrale në Dumnicë-Zogaj dhe Shotë Galica; Fitim Rifati, Shotë Galica gjatë Luftës së Parë Botërore (1914-1918). Fjalën e mbylljes e mbajti prof. dr. Sabile Keçmezi-Basha, këshilltare shkencore në Institutin e Historisë “Ali Hadri”.

c. Ekspozitë tematike kushtuar Nënë Terezës “shenjtorja shqiptare, letërkëmbimet”

Instituti i Historisë në bashkëorganizim me Institutin e Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve - Shkup dhe Ipeshkvinë e Republikës së Kosovës, kanë përgatitur dhe

organizuar një ekspozitë me fotografi e dokumente të titulluar “Shenjtorja shqiptare nga Shkupi – korrespondenca”, që i kushtohej 107 vjetorit të lindjes, 20 vjetorit të vdekjes dhe 1 vjetorit të shenjtërimit të Shën Nënë Terezës.

Fjalë rasti mbajtën përfaqësuesit e tri institucioneve të lartpërmendura: Gjon Berisha, nga Instituti i Historisë, Don Lush Gjergji nga Ipeshkvia e Kosovës dhe Skender asani nga ITSHKSH. Ekspozita u hapë në Bibliotekën Kombëtare të Kosovës “Pjetër Bogdani”, më 26 gusht 2017 në ora 14:00 dhe u mbajt e ekspozuar deri më 5 shtator 2017.

2. VEPRIMTARIA BOTUESE

Në kuadër të veprimtarisë themelore të Institutit, një vend të rëndësishëm zënë botimet e IH, të cilat janë rezultat i punës kërkimore shkencore të studiuesve dhe organizimit të konferencave e sesioneve shkencore si dhe të vetë revistës “Kosova” nr. 42 të Institutit.

a) Libra të botuara nga Instituti i Historisë në vitin 2017:

1. 50 vjet të Institutit të Historisë, Prishtinë: Instituti i Historisë “Ali Hadri”, 2017, 264 f.
2. Sabit Syla, 1981 Demonstratat e Kosovës në Arkivin Kombëtar të Londrës, Prishtinë: Instituti i Historisë “Ali Hadri”, 2017, 498 f.
3. Mark Palnikaj, Pulti: viti 743-10 mars 2005, Prishtinë: Instituti i Historisë “Ali Hadri”, 2017, 317 f.
4. Sabile Keçmezi-Basha, Kosova 1945-1990 (vështrim historiko-politik), Prishtinë: Instituti i Historisë “Ali Hadri”, 2017, 576 f.
5. Alban Dobruna, Tarikati Islam Halveti te shqiptarët, Prishtinë: Instituti i Historisë “Ali Hadri”, 2017, 420 f.
6. Emine Kalaja-Hajdari, Procese shndërrimesh ekonomike, social-politike dhe kulturore në dardani në periudhën romake, Prishtinë: Instituti i Historisë “Ali Hadri”, 2017, 350 f.
7. Sabit Syla, Shteti shqiptar dhe çështja e Kosovës 1939-1981 (botimi i dytë), Prishtinë: Instituti i Historisë, 2017, 460 f.
8. Gjon Berisha, Arbërorët ndërmjet Kishës Perëndimore dhe asaj Lindore gjatë shekujve XI-XV (botimi i dytë), Prishtinë: Instituti i Historisë “Ali Hadri”, 2015, 700 f.
9. Frashër Demaj, Britania e Madhe dhe çështja shqiptare: 1875-1913 (botimi i dytë), Prishtinë: Instituti i Historisë, 2017, 360 f.

b) Revista:

1. Revista shkencore “Kosova, nr.42”: organ i IH, Prishtinë 2017, 320 f.

3. HULUMTIMET SHKENCORE NË ARKIVA NDËRKOMBËTARE DHE REALIZIMI I PROJEKTEVE

a) Projektet shkencore të financuara nga MASHT

Projekti “Historia e Kosovës”

1. Ekspeditat kërkimore

Në bazë të marrëveshjeve për hulumtime kërkimore-shkencore në arkiva dhe biblioteka, pas aprovimit të projektit “Historia e Kosovës”, ka filluar puna në realizimin e fazave të projektit në fjalë. Bazuar në planin e punës, fillimisht është përfunduar faza e parë, që konsiston në strukturimin e kapitujve dhe temave që më pas është shoqëruar me përcaktimin e shkruarve/autorëve për tema të caktuara dhe lidhjen e kontratave përkatëse. Më pas, sipas prioriteteve dhe nevojave, nga anëtarët e projektit janë organizuar ekspedita kërkimore në Arkiva të ndryshme të vendeve të Ballkanit dhe atyre evropiane. Nga këto ekspedita është arritur që të grumbullohet një sasi e konsiderueshme dokumentesh, që përfshijnë periudhën nga Mesjeta gjerë te lufta e fundit e UÇK-së.

Nga ekspedita në Arkivin Shtetëror të Dubrovnikut, janë sjellë një sasi e konsiderueshme e dokumenteve në formë digjitale, të cilat mbulojnë një periudhë mesjetare prej më shumë se shtatëqind vjeçare. Një pjesë e tyre janë përzgjedhur vetëm për ngjarjet që kanë të bëjnë me Kosovën, kurse disa seri (*Reformaciones, Acta Concili Minorum, Acta Concili Rogatorum, Acta Mariae Maioris, Diversa Cancellariae, Diversa Notariae*, etj) janë vjel në mënyrë sistematike për të gjithë shqiptarët dhe viset e tyre në Mesjetë.

Një vend tjetër me mjaft rëndësi për projektin tonë janë edhe arkivat e Vjenës, në të cilat, dy studiues kanë marrë pjesë në Arkivin Kombëtar, në Arkivin e Luftës, në Bibliotekën Kombëtare të Vjenës dhe në disa arkiva tjerë, nga të cilët janë sjellë dokumente, kryesisht të shek.XVI-XVIII. Nga këto arkiva, përveç te tjerave na janë sjellë dokumente që lidhen drejtpërsëdrejti me luftërat austro-osmane, operacionet ushtarake të trupave perandorake Habsburge në viset e Nishit, Prishtinës, Prizrenit, Kaçanikut e Shkupit gjatë viteve 1689-1690 dhe posaçërisht me përfshirjen e popullsisë shqiptare në ngjarjet e vrullshme të atyre viteve. Përveç dokumenteve të lartpërmendura kemi edhe një sere materialesh nga botime të vjetra e të reja ku trajtohen probleme të historisë mesjetare të Kosovës, Rashës e Malit të Zi (Zetës) si dhe marrëdhëniet shqiptaro sllave në shekujt VI-XIV. Po ashtu, dokumente të botuara lidhur edhe me luftërat *Habsburgo-Otomane* të viteve 1737-1740.

Hulumtime janë kryer edhe në Bibliotekën e Kongresit të SHBA-ve, në Arkivin e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Mbretërisë së Bashkuar, ku janë sjellë me mijëra dokumente për Lidhjen Shqiptare të Prizrenit, Luftërat Ballkanike, Luftën e Parë dhe të Dytë Botërore, Demonstratat e vitit 1981, etj. Më tej si rezultat i punës kërkimore, ekspedita shkencore janë kryer edhe në Arkivin Politik të Ministrisë së Punëve të Jashtme në Berlin dhe në Arkivin Ushtarak në Freiburg të Gjermanisë, me fokus historinë e shqiptarëve të shekullit XX. Në Arkivin Politik të Ministrisë së Punëve të Jashtme janë grumbulluar materiale për historinë e shqiptarëve duke filluar që prej Shpalljes së Pavarësisë e gjerë te Demonstratat e Kosovës në vitin 1981 e në vazhdim deri në vitin 1985. Ndërsa në Arkivin Ushtarak të Freiburgut kryesisht kemi dokumente nga historia e shqiptarëve gjatë LDB, si krijimi i Divizionit SS “Skënderbeu” në Kosove, Lufta Nacionalçlirimtare etj. Përveç Arkivave të lartpërmendura, si rezultat i punës hulumtuese, studiuesit kanë sjellë edhe një sërë dokumentesh nga Arkivi i Maqedonisë, Arkivi i Sllovenisë, Bullgarisë, me pas dokumente nga Arkivi i Italisë, Francës, Arkivat e Perandorisë Osmane (Dokumente nga fondet me interes për historinë e Kosovës gjatë periudhës osmane duke përfshirë

regjistrimet e shekujve XV-XIX, defterë të popullsisë së kazave të ndryshme të fillim shek. XIX, raportet e komisionit të Shkupit për shpërnguljet shqiptare etj), Arkivat e Republikës së Re Turke, etj.

Materiale dokumentare me rëndësi janë sjellë edhe nga Arkivat e Shqipërisë e së fundmi edhe nga Arkivat e Beogradit, përkatësisht nga Arkivi i Jugosllavisë, fonde me interes për problemin shqiptar midis dy luftërave botërore siç janë: Shpërngulja e shqiptareve, Komiteti i Kosovës dhe Lëvizja Kaçake, emigracioni politik shqiptar në Jugosllavi midis dy luftërave botërore, dokumente për Bajram Currin, Bedri Pejani, Ferhat Dragen etj, si dhe raporte diplomatike për marrëdhëniet jugosllave-shqiptare etj.

Të gjitha, dokumentet janë të një cilësie shumë të lartë dhe mund të riprodhohen, fotokopjohen etj.

b) Pjesëmarrje të studiuesve në konferenca kombëtare e ndërkombëtare

Në rrafshin individual studiuesit e Institutit kanë marrë pjesë në një mori aktivitete shkollore si brenda ashtu edhe jashtë vendit, si: Konferenca vjetore e shkencës “*Java e Shkencës 2017*”, organizuar nga MASHT në Prishtinë, 12-15 maj 2017, në të cilën, me kumtesa kanë marrë pjesë 5 studiues nga Instituti i Historisë; Konferenca Shkollore “*Java e Albanologjisë*”, organizuar nga Instituti Albanologjik në Prishtinë, 14-18 qershor 2017 – me pjesëmarrjen e 3 studiuesve nga Instituti i Historisë.

4. Botime në revista relevante ndërkombëtare të indeksuar në bazat e të të dhënave me impact factor.

Studiuesit e Institutit në kuadër të planifikimeve dhe kërkimeve të tyre, një pjesë të punës së tyre kërkimore shkollore e kanë publikuar në revista ndërkombëtare, kryesisht në gjuhën angleze, gjë që e rrit vlerën dhe lejueshmërinë e tyre në gjuhët ndërkombëtare. Gjithsej në këto revista shkollore janë botuar 12 studime të publikuara në revistat:

- *European Academic Research*
- *Studime Historike*
- *Academic Journal of Business Administration, Law and Social Sciences*
- *Anglisticum*
- *Yu Historja,*
- *Albanologjia, International Journal of Albanology,*
- *European Journal of Social Sciences Studies etj.*

5. PUNËT ORGANIZATIVE DHE ADMINISTRATIVE

a) Këshilli Drejtues

Në vazhden e rishikimit të tërësisë së akteve të brendshme të Institutit me të cilat e bazon punën e tij, funksionon edhe *Këshilli Drejtues* i përbërë nga dy përfaqësues të emëruar nga

MASHT (Agim Zogaj dhe Haxhi Ferati) dhe tre nga Instituti i Historisë (Sabit Syla, Frashër Demaj dhe Arber Kuqi) nën kryesimin (në cilësinë e kryetarit të KD) e drejtorit të IH, Prof.assoc. dr.Sabit Syla.

Ju përshëndesim me konsideratë të veçantë!

